



MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
PRANUAR - PRIMERI NO
No. 714 Dt. 25/03/08
PRISHTINË - PRISHTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Duke u bazuar nenin 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkoħshme të Vetqeverisjes në Kosovë, dhe neni 42.9, të Ligjt pér Gjuetinë Nr. 02 / L-53 të datës 16.12.2005, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/41 të datës 11.08.2006,
Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 8/2008

**PËR PËRMBAJTJEN, MËNYRËN E HARTIMIT DHE PROCEDURAT E APROVIMIT
TË PLANEVE TË MENAXHIMIT ME VENDGJUETI**

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohet përmbajtja, mënyra e hartimit, dhënia e pëlqimit dhe procedura e aprovimit të planeve menaxhuese afatgjata dhe vjetore në vendgjueti.

Neni 2

Plane menaxhuese pér vendgjetinë janë bazë themelore pér rregullimin e menaxhimit të qëndrueshëm me kafshë të egra, në mbështetje të mbrojtjes, kultivimit, shfrytëzimit, reprodukimit, ruajtjes së llojeve autoktone dhe baraspeshës biologjike të tyre.

Neni 3

- 3.1 Hartimi i planeve afatgjata (10 vjeçare) të menaxhimit me vendgjueti përfshinë:
- përcaktimin e llojeve të kafshëve të egra të cilat natyrshëm jetojnë apo kryesisht kultivohen, varësisht nga destinimi i tokës ;
 - përcaktimin e sipërfaqeve produktive të vendgjuetive, sipas llojeve të kafshëve të egra me rendësi pér menaxhim;
 - caktimin e numrit të kafshëve të egra që mund të kultivohen, dhe
 - përkujdesi pér llojet tjera të kafshëve, të cilat dukshëm ndikojnë në menaxhimin e gjetisë.

DEFINICIONET

Neni 4

- 4.1 Përveç definicioneve të përfshira në nenin 3 të Ligjit për Gjuetinë, shprehjet dhe termet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë domethënien:
- a) “**Viti i gjuetisë**”- është periudha prej 01 Prillit të vitit vijues deri me 31 Mars të vitit të ardhshëm ;
 - b) “**Fondi amë**” – është numri i kafshëve të egra në fillim të vitit të gjuetisë ;
 - c) “**Fondi i çiftëzimit** ”- është fondi kafshëve të egra në fillim të vitit të gjuetisë i aftë për shumim ;
 - d) “**I vogli** ”- është kafsha e egër e moshës deri në fund të vitit të parë të gjuetisë, përveç te ariu ku i vogli është edhe gjatë vitit të dytë të gjuetisë ;
 - e) “**Të vegjlit** ”- janë kafshët e egra gjatë vitit të dytë të gjuetisë, përveç te ariu që janë edhe gjatë vitit tretë të gjuetisë ;
 - f) “**Kapaciteti menaxhues i vendgjuetisë**”- është numri i mundshëm i kafshëve të egra në vendgjeti i cili përfshinë numrin amë dhe shtimin e tyre vjetor ;
 - g) “**Gjahu i rregullt**”- është gjuetia e kafshëve të egra sipas sezonit dhe kalendarit të gjuetisë ;
 - h) “**Gjahu reduktues**” - është gjuetia në kafshët e egra kur populacioni i tyre nuk është në harmoni me ekuilibrin biologjik dhe kur ato shkaktojnë dëme pronës për shkak të numrit të madh të tyre ;
 - i) “**Gjahu sanitari**”- është eliminimi i kafshëve të egra të sëmura, lënduara apo plagosura ;
 - j) “**Vrasja emergjente**”- është kur kafsha e egër kërcënë dëmtimin e shpejtë dhe të rëndë të jetës së njerëzve apo dëmtimet e mëdha të pronës ;
 - k) “**Mbetjet**”- janë kafshët apo pjesët e kafshëve të egra të ngordhura, të mbytura në aksident komunikacioni dhe gjuetia e palejuar e evidentuar;
 - l) “**Ushqimi ekzistues**” - është ushqimi dhe uji që kafshët e egra e kanë ne dispozicion gjatë tërë vitit ;
 - m) “**Ushqimi plotësues**” nënkupton ushqimin, ujin, kripën dhe përzierjet tjera të mineraleve të cilat kohë pas kohe u jepen kafshëve të egra si plotësim i ushqimit dhe ujut natyror kur këto nuk janë të mjaftueshme;
 - n) “**Sipërfaqja produktive** ” - nënkupton pjesët e vendgjuetisë ku lloji i caktuar i kafshëve te egra i ka të gjitha kushtet natyrore për qëndrim, ushqim, ujë, shumëzim dhe strehim ;
 - o) “**Bonifikimi**” – është klasifikimi (produktiviteti) i vendgjuetisë për çdo lloj të kafshëve të egra ;
 - p) “**Kultivimi artificial**” - nënkupton kultivimin e kafshëve të egra me metoda të kontrolluara me ndihmën e mjeteve teknike.

Neni 5

- 5.1 Kafshët e egra sipas këtij Udhëzimi Administrativ ndahen në: lloje kryesore dhe lloje tjera (dytësore):
- a) llojet kryesore - janë kafshët e egra të cilat lirshëm jetojnë në natyrë, kultivohen ose planifikohet të kultivohen, si dhe llojet e kafshëve të egra për të cilat është caktuar sipërfaqja produktive e gjuetisë.
 - b) llojet tjera (dytësore) – janë kafshët e egra të cilat lirshëm jetojnë në natyrë, të sjellura dhe ato migruese.

Neni 6

6.1 Sipas mënyrës së migrimit kafshët e egra ndahan në :

- a) lloje të përhershme :
 - (i) të cilat gjatë tërë vitit qëndrojnë në vendgjeteti, gjejnë ushqim, strehim dhe shumohen;
- b) lloje sezionale:
 - (i) shtegtar kalimtar - të cilat gjatë një viti të gjetisë kalojnë prej një vendgjetie në tjetrën varësisht nga stina e vitit.
 - (ii) shtegtar verorë –janë ato lloje të cilat në vendgjeti vijnë gjatë pranverës, ushqehen, strehohen dhe shumohen, ndërsa në vjeshtë largohen;
 - (iii) shtegtar dimëror - vijnë në vendgjeti gjatë vjeshtës dhe dimrit, qëndrojnë, ushqehen kurse ne pranverë largohen ;
 - (iv) llojet e kohëpaskohshme, – janë lloje të cilat vijnë në vendgjeti vetëm gjatë ndonjë viti ku ushqehen, strehohen dhe shumohen ;
- c) llojet kalimtare - të cilat gjatë migrimit të tyre kalojnë nëpër vendgjeti.

6.2 Migrim sipas këtij Udhëzimi Administrativ nuk konsiderohen lëvizjet ditore të kafshëve të egra.

Neni 7

Fondi amë i kafshëve të egra në vendgjeteti duhet të konstatohet deri më 31 mars për vitin e ardhshëm të gjetisë, ndërsa për llojet sezionale pas arritjes në vendgjeti.

PLANI MENAXHUES AFATGJATË (10 VJEÇARË)

Neni 8

8.1 Plani menaxhues afatgjatë është akt planifikues me të cilin rregullohet menaxhimi në vendgjeteti, duke përfshirë llojin dhe numrin e kafshëve të egra në përputhshmëri me madhësinë dhe strukturën e sipërfaqes të vendgjetisë.

8.2 Plani menaxhues dhjetëvjeçarë i vendgjetisë duhet të jetë në pajtim me Strategjinë e Menaxhimit me Kafshë të Egra, planet e menaxhimit me pyje dhe shfrytëzimit të tokave, planet hapësinore, Ligjin e Gjetisë, Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, dhe në harmoni me konventat ndërkombëtare nga kjo lëmi.

Neni 9

9.1 Numri i kafshëve të egra nga nen 7 i këtij Udhëzimi Administrativ konstatohet :

- a) Kafshët e trasha (mëdha) – duke i vrojtuar, përcjellë dhe numëruar gjatë tërë vitit të gjetisë në vendgjeteti dhe pasqyrohen numerikisht sipas strukturës gjinore dhe moshës ;
- b) Kafshët e imta (vogla):
 - (i) lepujt, fazanët, thëllëzat gurore dhe të fushës - përcaktohen me metodën e mostrave duke i numëruar në sipërfaqe provë të madhësisë prej se paku 50 ha, largësia në mes të cilave nuk mund të jetë më e vogël se 1000 m. Në rast se nuk ka mundësi të vendosen sipërfaqe provuese, atëherë numri i kafshëve të egra konstatohet duke i përcjell dhe numëruar gjatë tërë vitit të gjetisë ;
 - (ii) patat e egra - numri përcaktohet me vrojtimin të përhershëm, vrojtimin e daljes së tyre ne sipërfaqe të ujërave, në fluturimet e mëngjesit dhe të mbrëmjes dhe në ushqimore;

(iii) kafshët e egra tjera të imta duke i vrojtuar, përcjell dhe numëruar gjatë tërë vitit të gjuetisë.

9.2 Numri i kafshëve të egra mundë të konstatohet edhe në mënyra dhe metoda tjera të pranuara në praktikën e gjuetisë, siç janë:

- a) me mjete teknike - inqizimi nga ajri, me radar, radio transmetues, përmes markimit (shënjimit), etj ;
- b) me metodën e Linkolnit - markim (shenjim) i pjesërishëm ;
- c) me metodën e konstatimit të gjurmëve ;
- d) me metodën e përcaktimit të fekaleve ;
- e) me metodën e përgjimit;

Neni 10

10.1 Kafshët e egra, sipas rregullit, kultivohen në raport gjinor 1: 1.

10.2 Përjashtim nga paragrafi 1, i këtij neni, raporti gjinor mund të ndryshoi për arsyet të:

- a) arritjes më të shpejt të kapacitetit të caktuar menaxhues të vendgjetisë ;
- b) realizimit të gjuajtjes (vrasjes) më të madhe me qëllim të përfitimit të sasive me të mëdha të mishit;
- c) kultivimit të trofeve kulminante të kafshëve të egra ;
- d) realizimit te objektivave të parapara të menaxhimit me vendgjeti ;
- e) zvogëlimit të dëmeve nga kafshët e egra dhe në kafshë të egra , dhe
- f) zvogëlimit gradual të numrit të kafshëve të egra në vendgjeti.

Neni 11

11.1 Kafshët e mëdha të egra ndahen sipas gjinisë në këto klasa të moshave: të veglit, të reja ,të mesme dhe të rritura.

11.2 Kafshët e imta të egra ndahen sipas gjinisë dhe moshës : të vogla dhe të rritura.

Neni 12

Gjatë hartimit të planit të menaxhimit përcaktohen sipërfaqet produktive të gjuetisë për çdo lloj të kafshëve te egra për të cilën bëhet bonifikimi i vendgjetisë.

Neni 13

13.1 Me bonifikimin e vendgjetisë përcaktohet numri më i madh i mundshëm i kafshëve të egra të cilat mund të kultivohen në vendgjeti e që nuk prishin raportet e ndërsjella natyrore në mes kafshëve të egra dhe llojeve tjera të mbrojtura, apo veprimtarin e menaxhimit.

13.2 Bonifikimi i vendgjetisë bëhet për kafshë të egra me rendësi për menaxhim, të cilat në vendgjeti qëndrojnë dhe jetojnë apo kryesisht kultivohen, në pajtim me planet menaxhuese 10 vjeçare të deritanishme të gjuetisë, udhëzimet ekzistuese apo praktikave te përdorura të deritanishme, deri sa Ministria të nxjerr udhëzimet profesionale për bonifikim dhe identifikim të sipërfaqeve produktive të vendgjuetive në Kosovë.

13.3 Numri i mundshëm i kafshëve të egra për të cilat nuk ekzistojnë udhëzimet dhe shënimet e bonifikimit nga ish planet menaxhuese 10 vjeçare te gjuetisë, përcaktohet në bazë të vlerësimit nga ekspertët e gjuetisë për çdo vendgjeti.

Neni 14

14.1 Shtimi llogaritet për vit gjuetie dhe për çdo lloj të kafshës se egër e cila jeton në

vendgjeti në bazë të metodave, udhëzimeve apo praktikave të përdorura të deritanishme dhe planit të menaxhimit. Shtimi i llogaritur mund të ndryshoi, varësisht nga kushtet natyrore dhe kushtet tjera gjatë të njëjtë vit.

14.2 Shtimi i kafshëve të egra dhe llojeve tjera për të cilat nuk ekzistojnë metoda apo udhëzime në praktikën e deritanishme, llogaritet në bazë të vlerësimit. Nëse dyshohet në realizimin e shtimit të llogaritur, atëherë mund të kryhet numërimi kontrollues para fillimit të sezonit të gjetisë.

Neni 15

15.1 Gjetia në llojet e kafshëve të egra (tradicionale për gjeti, të rralla, të rezikuara dhe përherë të mbrojtura), planifikohet sipas llojit në pajtim me numrin e tyre, raportit gjinor, moshës dhe objektivave të përcaktuara në planet e menaxhimit.

15.2 Sjellja e kafshëve të egra në vendgjeti bëhet sipas planifikimit dhe kapacitetit të vendgjetisë.

15.3. Kafshët e ngordhura, të plagosura apo të pësuara në mënyra tjera, llogariten në humbjen apo vrashjen e përgjithshme.

Neni 16

Në vendgjeti duhet ndërtuar objekte menaxhuese të cilat dedikohen për kultivimin dhe mbrojtjen e kafshëve te egra dhe objektet teknike përcjellëse të cilat mundësojnë realizimin e planit menaxhues.

Neni 17

17.1 Kufijtë e vendgjetisë shënohen në tabela të madhësisë jo më të vogla se 60 x 40 cm, në të cilat shkruhet qartë emri i vendgjetisë, destinimi i vendgjetisë, menaxhuesi i vendgjetisë, ndërsa për vendgjetitë private edhe pronari i vendgjetisë;

17.2 Tabelat vendosën në vendet e caktuara, kryesisht në hyrje të rrugëve dhe në vendet tjera të parapara me aktin e themelimit të vendgjetisë.

Neni 18

18.1 Masat e mbrojtjes së kafshëve te egra përfshijnë:

- a) ruajtjen e vendgjetisë;
- b) pengimin e gjetisë së kundërligjshme;
- c) mbajtjen e numrit optimal të kafshëve të egra ;
- d) evitimini e qenve dhe maceve endacakë ;
- e) zbatimin e masave preventive, shëruese dhe masave tjera higjeniko - shëndetësore në vendgjeti për ruajtjen shëndetësore të kafshëve të egra ;
- f) mbrojtja e kafshëve të egra nga fatkeqësítë elementare (bora, akulli, përmbytjet, zjarri etj.)
- g) sigurimin e qetësisë në vendgjeti;
- h) ndërmarrjen e masave preventive gjatë kryerjes se punëve bujqësore dhe punëve tjera ose gjatë përdorimit të preparateve kimike;
- i) rregullimin dhe mirëmbajtjen e burimeve, puseve, lugjeve (koritave) dhe vendeve tjera ku qëndron uji;
- j) sigurimin e kushteve për ekzistencë dhe shumim të llojeve te kërcënuara;
- k) zbatimin e masave tjera të parapara me kontrata dhe konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e llojeve migruese.

Neni 19

19.1 Me qëllim të përcjelljes së gjendjes numerike të llojit të caktuar të kafshës së egër, në planin menaxhues mund të parashihet obligimi i përcjelljes së peshës së kafshës së njëjtë sipas viteve te gjuetisë;

19.2 Pesha e kafshës së egër evidentohet pas gjuajtjes, sipas moshës dhe pa organet e brendshme, pa kokë dhe pa këmbë deri në gju.

Neni 20

20.1 Plani i menaxhimit përmban:

- a) Hyrjen,
- b) Shënimet për vendgjetinë, si :
 - (i) vizioni - kahet e menaxhimit për vendgjetinë,
 - (ii) qëllimi i menaxhimit të vendgjetisë,
 - (iii) plani ekonomiko – finansiar i menaxhimit të vendgjetisë ;
 - (iv) masat për pengimin e dëmeve në kafshë të egra dhe nga kafshët e egra,
 - (v) shënimet themelore të vendgjetisë,
 - (vi) të dhënat mbi menaxhuesin e vendgjetisë,
 - (vii) rezultatet paraprake menaxhuese,
 - (viii) gjendja aktuale e vendgjetisë,
 - (ix) pasqyrimin e llojeve dhe numrit të kafshëve të egra në vendgjeti ;
 - (x) kronika e gjuetisë ;
 - (xi) përshkrimi i vendeve të rëndësishme natyrore të vendgjetisë ;
 - (xii) kushtet e mbrojtjes së natyrës ;
 - (xiii) përshkrimin e pajisjeve teknike të vendgjetisë;
- c) Menaxhimin me kafshë të egra dhe vendgjetinë duke përfshi :
 - (i) kinologjinë e gjuetisë;
 - (ii) gjetinë dhe shfrytëzimin e kafshëve të egra;
 - (iii) shërbimin profesional dhe shërbimin e rojës ;
 - (iv) investimet e nevojshme në kafshë të egra dhe vendgjeti;
 - (v) objektet e menaxhimit dhe objektet tjera teknike përcjellëse;
 - (vi) harta e vendgjetisë.

Neni 21

21.1 Planit të menaxhimit i bashkëngjitën:

- a) vendimi mbi regjistrimin e veprimtarisë;
- b) vendimi mbi themelimin e vendgjetisë;
- c) vendimi mbi dhënien në menaxhim të vendgjetisë;
- d) kontrata mbi shfrytëzimin (menaxhimin) e vendgjetisë;
- e) vendimi mbi zonat e mbrojtura – rezervatet në vendgjeti;
- f) harta topografike në përpjesëtim 1:25 000;
- g) evidenca e trofeve të kafshëve të egra;
- h) procesverbali i komisionit të autorizuar profesional për aprovin e planit të menaxhimit dhe
- i) akti i aprovimit të planit të menaxhimit.

Neni 22

Hyrja e planit të menaxhimit përmban: vërejtjet themelore, kohëzgjatjen e planit, emrin e personit juridik apo fizik i cili e ka hartuar planin e menaxhimit, shënimet themelore për

menaxhuesin e autorizuar të vendgjetisë, pasqyrën e literaturës profesionale dhe udhëzimet e shfrytëzuara për hartimin e planit.

Neni 23

Shënimet themelore për vendgjetinë përfshijnë të dhënat nga akti i themelimit te vendgjetisë me përshkrim të domosdoshëm të kufijve, sipërfaqes totale të klasifikuar sipas strukturës së kulturave, pronësisë dhe destinimit të vendgjetisë.

Neni 24

24.1 Përshkrimi i vendeve të rëndësishme natyrore të vendgjetisë, pasqyrohet nga:

- a) kushtet orografike, hidrografike dhe klimatike;
- b) përbërjen e tokës;
- c) bashkësitë bimore dhe bashkësitë tjera;
- d) infrastrukturën;
- e) ndikimet antropogjene e të ngjashme.

Neni 25

25.1 Lloji dhe numri i kafshëve të egra konstatohet në saje të vlerësimit të gjendjes aktuale.

25.2 Gjendja aktuale dhe numri i pajisjeve teknike përcjellëse të vendgjetisë bëhet përmes evidentimit.

25.3 Objektet e menaxhimit dhe objektet teknike përcjellëse të vendgjetisë nuk mund të planifikohen, të vendosën apo ndërtohen afér brezit prej 100 m. nga kufiri i vend-gjetisë, përvèç objekteve të menaxhimit me kafshë te imta (vogla) nëse kufiri i vend-gjetisë është sipërfaqe ujore.

Neni 26

Menaxhimi ka të bëjë me sipërfaqet në të cilat është themeluar vendgjetia dhe përfshin periudhën dhjet e më tepër vjeçare të menaxhimit. Në të paraqiten rezultatet e arritura në kultivim, mbrojtje, gjueti dhe shfrytëzim të kafshëve te egra, dëmet e shkaktuara nga kafshët e egra, punët e kryera në rregullimin e vendgjetisë dhe kujdesi për llojet tjera të kafshëve të cilat kanë ndikim të konsideruar në menaxhimin me gjuetinë.

Neni 27

27.1 Kahet – vizioni i menaxhimit për llojet e kafshëve të egra, përcaktohet si vijon:

- a) menaxhimin me gjueti i cili duhet të jetë në pajtim me destinimin e vendgjetisë, masat dhe kushtet e mbrojtjes së natyrës dhe i cili përcakton mënyrën e kultivimit, strukturën gjinore dhe moshën e kafshës;
- b) klasën e bonitetit, sipërfaqen produktive të menaxhimit, koeficientin e shtimit dhe kapacitetin menaxhues të vendgjetisë;
- c) numrin e kafshëve të egra në vendgjeteti;
- d) zhvillimin e fondit të kafshëve të egra për çdo vit gjuetie sipas strukturës gjinore dhe të moshës me planifikimin e shtimit dhe të gjuajtjes;
- e) nevojat për ushqim natyror dhe plotësues për çdo vit gjuetie;
- f) masat për rregullimin e vendgjetisë për çdo vit gjuetie;
- g) masat për mbrojtjen e kafshëve të egra;
- h) Masat e mbrojtjes dhe përmirësimit të vendgjetisë, pengimit të dëmeve nga kafshët e egra dhe në kafshët e egra ;

- i) Mënyrat e gjuetisë dhe përdorimit të armëve dhe të municionit të gjuetisë ;
- j) Kujdesi për llojet e kafshëve të egra në të cilat ndonjë lloj tjetër përkatës mund të ketë ndikim negativ.

Neni 28

Me dispozita të veçanta për kinologjinë e gjuetisë, përcaktohet numri dhe llojet e qenve të gjuetisë të cilët duhet të sigurohen për gjuetinë e llojeve te caktuara të kafshëve te egra.

Neni 29

Gjuetia dhe shfrytëzimi i kafshëve të egra, përcaktohet me Ligj dhe sipas udhëzimeve administrative për mënyrat e gjuetisë, përdorimit të armëve dhe municionit të gjuetisë.

Neni 30

Planet e investimeve në kafshë të egra dhe në vendgjeteti duhet të sigurojnë zbatimin e planit menaxhues dhe shuma financiare tregohet nga udhëheqësi i vendgjetisë në fund të periudhës së vlefshmërisë së planit.

Neni 31

Zbatimi i dispozitave të planit të menaxhimit evidentohet sipas viteve të gjuetisë, ndërsa tregohet - raportohet pas përfundimit të periudhës kohore në të cilën është i obliguar zbatimi i tyre.

Neni 32

Kronika e gjuetisë evidentohet në mënyrë kronologjike për çdo vit gjuetie, të gjitha ngjarjet që ndodhin në vendgjeteti të cilat kanë ndikim të konsiderueshëm në menaxhimin me gjuetinë e sidomos:

- a) ndikimin negativ të fatkeqësive natyrore;
- b) shtimin e realizuar të disa llojeve të kafshëve të egra;
- c) gjendjen e florës dhe faunës;
- d) ardhjen dhe shkuarjen e llojeve sezonale (migrimi);
- e) aktivitetet e shërbimeve profesionale dhe të rojeve të gjahut;
- f) dëmet nga kafshët e egra në kafshë të egra dhe në vendgjeteti;
- g) përcjellja - vrojtimi i kafshëve të egra përherë të mbrojtura, të rralla dhe të rrezikuara;
- h) eksperimentet për hulumtime shkencore;
- i) ndikimet e njeriut, dhe
- j) të gjitha ngjarjet të cilat mund të kushtëzojnë revizionin e planit të menaxhimit.

Neni 33

33.1 Revidimi - rishikimi i planit të menaxhimit bëhet:

- a) nëse sipërfaqja e përgjithshme e vendgjetisë apo sipërfaqja produktive e gjuetisë e përcaktuar me planin menaxhues për çdo lloj të kafshëve të egra, ndryshon më tepër se 20%;
- b) nëse nuk mundë të arrihet fondi amë sipas parashikimeve me plan të menaxhimit;
- c) nëse me ndërtimin e objekteve dhe infrastrukturës apo punëve të ngashme, dukshëm është çrregulluar tërsia biologjike e vendgjetisë apo nëse për

- çfarëdo shkaqesh është ndryshuar klasa e bonifikimit për cilindo lloj të kafshëve të egra;
- d) nëse lajmërohen apo sillën lloje të reja të kafshëve te egra në vendgjetet ;
 - e) nëse nuk është në harmoni me dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ dhe Ligjit të Gjetisë.
- 33.2 Revidimi - rishikimi bëhet sipas procedurës së njëjtë që parashihet për nxjerrjen dhe aprovin e planit.

Neni 34

- 34.1 Gjetia dhe zvogëlimi i numrit të kafshëve të egra në një vendgjetet gjatë një viti të gjetisë nuk mund të ketë tejkalime nga objektivat e parapara të menaxhimit më shumë se:
- a) 25% nga planifikimi për të gjitha llojet e kafshëve te mëdha, përveç te derri i egër ku tejkalimi mund të jetë deri në 30%;
 - b) 35 % për kafshë të imta.
- 34.2 Te fondi amë nuk mund të ketë tejkalime nga planifikimi, për tri vite të njëpasnjëshme të gjetisë, më shumë se:
- a) 15% për kafshë të mëdha;
 - b) 25% për kafshë të imta;

Neni 35

- 35.1 Hartimi i planeve menaxhuese afatgjata duhet të përgatitet nga menaxhuesit e vendgjuetive.
- 35.2 Procedurat rreth hartimit dhe miratimit të planeve menaxhuese afatgjata duhet të bëhen sipas nenit 42.2 dhe 42.5 të Ligjit të Gjetisë.

PLANI VJETOR I MENAXHIMIT

Neni 36

Planet vjetore të menaxhimit hartohen çdo vit deri në fund të muajit Mars në pajtim me planin menaxhues 10 vjeçar dhe me gjendjen faktike të vendgjetisë, kafshëve të egra dhe objekteve në vendgjetet.

Neni 37

Menaxhuesi i vendgjetisë është i obliguar që në afatin e caktuar,

- a) të bëjë përshkrimin tekstual dhe plotësimin e formularëve për gjendjen e kafshëve të egra, gjetisë, ushqimit dhe objekteve në vendgjetet për vitin e kaluar të gjetisë (gjendjen e realizuar sipas formularëve - tabelave të bashkangjitura);
- b) të përgatit procesverbalin për numërimin e kafshëve të egra;
- c) të përgatit procesverbalin për dëmet në kafshë te egra, numrin e kafshëve të ngordhura apo në mënyrë tjetër të pësuara;
- d) të plotësoi rubrikën "Planifikimi" për vitin paraprak të gjetisë në formularët përkatës i cili është bashkangjitur këtij Udhëzimi Administrativ

Neni 38

- 38.1 Hartimin e planeve vjetore të menaxhimit duhet ta përgatit menaxheri i vendgjetisë.
- 38.2 Plani vjetor i menaxhimit për vendgjetetë me rëndësi të veçantë aprovohet nga Ministria, ndërsa planet vjetore menaxhuese të vendgjuetive të përbashkëta dhe private aprovoohen nga Komuna, me pëlqimin paraprak të Ministrisë.

- 38.3 Dërgimi i planeve vjetore për miratim bëhet deri më 31 Mars të vitit vijues.
- 38.4 Nëse plani vjetor i menaxhimit refuzohet të aprovohet, menaxhuesi i vendgjuetisë është i obliguar ta përmirësoj planin menaxhues në afat prej 30 ditësh.
- 38.5 Nëse brenda 30 ditësh, të autorizuarit për aprovim nuk deklarohen atëherë plani menaxhues konsiderohet i aprovuar.

Neni 39

Deri në aprovimin e planeve vjetore menaxheri i vendgjuetisë është i obliguar të zbatoi masat e kultivimit dhe të mbrojtjes së kafshëve të egra, por nuk i lejohet gjuetia.

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 40

Planet ekzistuese të menaxhimit të vendgjuetisë mbesin ne fuqi deri ne themelimin dhe dhënien në menaxhim të vendgjuetive.

Neni 41

Anekset 1 deri 14 të cilat përfshinë formularët dhe tabelat nga 1 deri 10 janë pjesë përbërëse të planit të menaxhimit dhe tre formular të procesverbaleve janë pjesë përbërëse të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 42


Mos zbatimi i dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ sanksionohet sipas dispozitave të nenit 61 të Ligjit për Gjuetinë.

Neni 43

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Prishtinë 21.03. 2008

Ministri i Ministrisë së
Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural


Idriz Vehapi

Aneksi - 1

tabela – 1

PASQYRA E SIPËRFAQEVE TË VENDGJUETIVE					
SIPËRFAQJA E VENDGJUETISË	STRUKTURA E SIPËRFAQE S	KULTURA	PRONËSIA	Ha	
1	2	3	4	5	
TOKA MBRENDA VENDGJUETISË	PYJE		PUBLIKE		
			PRIVATE		
			Σ		
			PUBLIKE		
			PRIVATE		
	TOKË BUJQQËSORE	ARA	Σ		
			PUBLIKE		
		LIVADHE	PRIVATE		
			Σ		
		KULLOSA	PUBLIKE		
	GJITHËSEJT TOKE BUJQESORE	KULTURA SHUMËVJEÇARE	PRIVATE		
			Σ		
		TË TJERA	PUBLIKE		
			PRIVATE		
	GJITHËSEJT TOKE BUJQESORE		PUBLIKE		
			PRIVATE		
UJRAT MBRENDA VENDGJUETISË	RRJEDHËSE	NATYRALE	LUMEJ		
			PRROCKA		
		ARTIFICIALE	Σ		
			KANALE		
		$\Sigma\Sigma$			
	JO RRJEDHËSE	NATYRALE	LIQEJE		
			MOQALE DHE KNETA		
			TJERA		
		ARTIFICIALE	Σ		
			AKUMULIMET		
			RETENZIVE		
		TË TJERA	Σ		
			$\Sigma\Sigma$		
SIPËRFAQJA E PËRGJITHSHME E GJUETISË SIPAS PRONËSISË	PUBLIKE				
	PRIVATE				
SIPERFAQJA E PËRGJITHSHME E GJUETISE					
SIPERFAQET NE TE CILAT NUK LEJOHET GJUETIA E QE JAN MBRENDA KUFIJVE TE VENDGJUETISE	TOKE NDERTIMORE (URBANE)				
	SIPËRFAQE PUBLIKE (rrugë, etj)				
	OBJEKTE NATYRORE NËN MBRO JTJE TE VEÇANTË				
	FIDANISHTE TE RRETHUARA				
	OBJEKTE TE PESHKATARISË-HURDHA				
	TE TJERA				
	Σ				
SIPERFAQJA E PËRGJITHSHME MBRENDA KUFIJVE TE VENDGJUETISË					

VIZIONI - KAHET E MENAXHIMIT TË ARDHËSHËM	
LLOJET E KAFSHËVE TË EGRA	
DESTINIMI I VENDGJUETISË	
QËLLIMI I MENAXHIMIT TË GJUETISË	
METODAT (MËNYRA) E KULTIVIMIT	
PROPORCIONI GJINORË (m: f)	
MOSHA MENAXHUESE E KAFSHVE (vetëm për kafshë te trasha-mëdha)	
STRUKTURA MOSHORE (Vetëm për kafshe te mëdha)	
SIPERFAQJA PRODUKTIVE E GJUETISE (SPGJ)	
KLASA E BONITETIT	
NUMRI I KAFSHVE TE EGRA NË NJËSINË E GJUETISË (100 HA)	
FONDI AMË - BAZIK	
KOEFICIENTI I SHTIMIT	
SHTIMI (SH)	
KAPACITETI I MENAXHIMIT=FONDI AMË+SHTIMI	

Aneksi - 3

Viti i gjahut (periudha): 01 prill _____ v. - 31 mars _____ v.

tabela – 3

		Zhvillimi i Fondit (Lloji kryesor i kafshëve të trasha (mëdha)																		
FONDET		STRUKTURA MOSHORE											Σ		ΣΣ					
		NJË VJEÇARE		DY VJEÇARE		E RE		E MESME		E RRITUR)										
		Krerë		Krerë		Krerë		Krerë		Krerë										
		M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F					
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	13	14	15				
FONDI AMË		PLANIFIKIMII																		
		REALIZIMI																		
KAFSHË TË EGRA TË SJELLURA		PLANIFIKIMI																		
		REALIZIMI																		
FONDI PER ÇIFTËZIM		PLANIFIKIMI																		
		REALIZIMI																		
SHTIMI		PLANIFIKIMI																		
		REALIZIMI																		
FONDI PARA GJUETISE		PLANIIFIKIIMI																		
		REALIZIMI																		
GJUET A	TE PLANIFIKAURA																			
	TË REALIZU ARA	GJUETI																		
		MBETJET																		
		Σ																		
FONDI PAS GJUETISË		I PLANIFIQUAR																		
		I REALIZUAR																		
DALJA		I PLANIFIQUAR																		
		I REALIZUAR																		

Aneksi – 4

Viti i gjuetisë (periudha): 01. prill v - 31. mars..... v.

tabela - 4

ZHILLIMI I FONDIT (Lloji kryesor i kafshëve të imta)								
		STRUKTURA MOSHORE				Σ	$\Sigma\Sigma$	
		TË VEGJËL		TE RRITUR				
M	F	M	F	M	F			
Krerë/ sqeparë (shpezë)								
1	2	3	4	5	6	7	8	9
FONDI AME	I PLANIFIKUAR							
KAFSHË TË EGRA TE SJELLURA	I REALIZUAR							
	I PLANIFIKUAR							
FONDI PER QIFTEZIM	I RELIZUAR							
	I PLANIFIKUAR							
SHTIMI	I REALIZUAR							
	I PLANIFIKUAR							
FONDI PARA GJUETISE	I REALIZUAR							
	I PLANIFIKUAR							
GJUETIA	PLANIFIKIMI							
	REALIZIMI		GJUETI					
			MBETURINA					
	Σ							
FONDI PAS GJUETISË		PLANIFIKIMI						
		REALIZIMI						

Aneksi - 5

tabela - 5

Aneksi – 6

tabela- 6

Aneksi - 7

tabela 7/a

Aneksi - 8

tabela 7/b

OBJEKTIVAT E MENAXHIMIT PËR (Llojet e Kafshëve tjera - te imta)									
VITI I GJUETISË			GJENDJA NUMERIKE PRANVERORE	KOEFICIENTI SHTIMIT	SHTIMI	EVITIMI			
						GJUETIA	MBETURINA	Σ	
01.04	PLANIFIKMI	Vendor							
		Kalimtar							
... 31.03	REALIZIMI	Vendor							
		Kalimtar							
... ...	PLANIFIKIMI	Vendor							
		Kalimtar							
... ...	REALIZIMI	Vendor							
		Kalimtar							
... ...	PLANIFIKMI	Vendor							
		Kalimtar							
... ...	REALIZIMI	Vendor							
		Kalimtar							
... ...	PLANIFIKMI	Vendor							
		Kalimtar							
... ...	REALIZIMI	Vendor							
		Kalimtar							
... ...	PLANIFIKMI	Vendor							
		Kalimtar							
... ...	REALIZIMI	Vendor							
		Kalimtar							

Aneksi - 9

tabela - 8

REKAPITULLIMI I PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË GJUAJTJES PËR KAFSHËT E EGRA TË MËDHA - TRASHA

Aneksi -10

tabela - 9

**REKAPITULIMI I PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË GJUAJTJES PËR
KAFSHËT E EGRA TË IMTA**

(Lloji kryesor i kafshëve të imta)									
VITI I GJUETISË	STRUKTURA E MOSHËS				Σ	$\Sigma\Sigma$			
	TË VOGLA		TË RRITURA						
	M	F	M	F	M	F			
Krerë									
1			2	3	4	5	6		
1. 04. .../ 31. 03...	PLANIFIKUAR								
REALIZUAR	TË VRARA								
	MBETURINA								
	Σ								
1							7		
1. 04. .../ 31. 03...							8		
PLANIFIKUAR									
REALIZUAR	TË VRARA								
	MBETURINA								
	Σ								
PLANIFIKUAR									
REALIZUAR	TË VRARA								
	MBETURINA								
	Σ								

Aneksi -11

tabela – 10

Aneksi - 12

Emërtimi i vendgjuetisë: _____

Vendi _____

Viti i gjuetisë: _____

Numër _____

PROCESVERBAL

Për konstatimin e gjendjes numerike të kafshëve të egra

Gjendja numerike u konstatua me datën _____ viti.

1. Kafshët e egra të trasha (mëdha)

	Njëveçare		Dyveçare		Të reja		Të mesme		Të rritura (pjekura)		Gjithsejt
	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	
	Krerë										
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

2. Kafshët e egra të imëta

	Numërimi në sipërfaqe provë(të caktuara)			Duke vërejtur, përcjellur dhe numëruar		
	M	F	Gjithësej	M	F	Gjithsej
	krerë / sqeporë			krerë / sqeporë		
1	2	3	4	5	6	7

3. Kafshë tjera të egra me rëndësi për menaxhim:

Llojet e kafshëve

krerë / sqeporë

Në _____, më datën _____

Personi profesional

(nënshtkrimi)

Me përgjegjësi morale dhe materiale vërtetoj saktësinë e shënimave.

Personi i autorizuar për gjueti

(nënshtkrimi)

V.V.

Aneksi - 13

Emërtimi i vendgjetisë: _____
Vendi : _____
Viti i gjuetisë: _____
Numër _____

PROCESVERBAL mbi dëmet në kafshë të egra

Komisioni për dëme në kafshë të egra me këtë procesverbal konstaton se më datën _____ është bërë dëm në kafshë të egra si vijon:

Në pjesën e vendgjetisë _____

Lloji i kafshëve të egra _____

Gjinia _____

Vlera e kafshëve të egra _____

Përshkrimi i shkaktarëve të dëmit në kafshë të egra:

Në _____, më datën _____

Personi profesional

(nënshkrimi)

Me përgjegjësi morale dhe materiale vërtetoj saktësinë e shënimave.

Personi i autorizuar për gjueti

(nënshkrimi)

V.V.

Komisioni:

1. Emri dhe mbiemri: _____, nënshkrimi: _____
2. Emri dhe mbiemri: _____, nënshkrimi: _____
3. Emri dhe mbiemri: _____, nënshkrimi: _____

Aneksi - 14

Emërtimi i vendgjuetisë: _____
Vendi: _____
Viti i gjuetisë: _____
Numër: _____

PROCESVERBAL

Për furnizimin plotësues dhe ushqimin e përhershëm në vendgjeti

Më datën _____ në pjesën e vendgjuetisë _____, në ushqimoren numër _____ është bërë plotësimi - përmirësimi i ushqimit për kafshë të egra, si vijon:

Lloji i kafshëve të egra

Lloji i ushqimit

Sasia e ushqimit (kg / ha)

Në _____, më datën _____

Personi profesional

(nënshkrimi)

Personi i autorizuar për gjueti

(nënshkrimi)

V.V.